



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 68/2 Prot.

Tiranë, më 15/12/2011

**Lënda:** Rekomandim për “Banka e Bashkuar e Shqipërisë” (UBA), Tiranë.

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211 datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, Tiranë.

**KONSTATOVA**

Në periudhën 20/10/2011- 05/12/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, Tiranë me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë, punonjës etj)
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara nga nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pasi shqyrtoi Proces-Verbalin mbi shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit administrativ, si dhe provat e administruara, vëren se:

1. Kontrolluesi “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, mbledh dhe përpunon të dhëna personale sensitive lidhur me **kombësinë** dhe **gjendjen gjyqësore** për kategorinë e subjekteve të të dhënave “*klient*”.

Mbledhja, përpunimi i të dhënave personale sensitive mbi kombësinë dhe gjendjen gjyqësore të klientëve është e tepërt dhe jo proporcionale lidhur me qëllimin për të cilin ato mblidhen dhe përpunohen.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur neni 5 pika 1 germa "c" e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "*..të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim*".

2. Kontrolluesi "*Banka e Bashkuar e Shqipërisë*" nuk ka kryer plotësisht detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Nuk është deklaruar mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për kategorinë "*aksioner*".

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur neni 21 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas të cilit "*Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë*".

3. Kontrolluesi "*Banka e Bashkuar e Shqipërisë*" mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV), jashtë ambienteve të kontrolluesit, duke monitoruar dhe pjesën e trotuarit dhe rrugës ngjitur me godinën e tij për kalimtarë të rastësishëm të cilët nuk janë subjekt i qëllimit të këtij përpunimi.

Mbledhja e të dhënave personale të kalimtarëve është e tepërt lidhur me qëllimin për të cilin kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV), duke qenë kështu në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neni 5 pika 1 germa "c", sipas të cilit "*..të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim*".
- Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*".
- Rregulloren "*Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare*" (neni 10 pika "a"), miratuar me Vendimin Nr. 04, datë 19/01/2011 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe të neneve 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

### REKOMANDOJ

1. Bazuar në Nenit 5 pika 1/c të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të mos mblidhni e të përpunoni të dhënat personale të "kombësisë" dhe "gjendjes gjyqësore", për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale "klient";
2. Bazuar në Nenin 30/1/b të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të fshini të dhënat personale të "kombësisë" dhe "gjendjes gjyqësore" nga sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave apo nga çdo format manual tip, si dhe t'i shkatërroni e t'i fshini këto të dhëna të mbledhur deri më tani për të gjithë "klientët", brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh;

3. Bazuar në nenet 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të realizoni njoftimin për përpunimin e të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “aksionerë”, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh;
4. Në zbatim Nenit 5, pika 1, gërma “c”, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, si dhe Rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare” (neni 10 pika “a”), të ndaloni mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV), tej fasadës të godinave ku ushtroni veprimtarinë bankare dhe financiare, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

